

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

Fakulteti Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti :Lavërtari-Perimtari



“ANALIZA E DISA POPULACIONEVE TË PATATES (*SOLANUM TUBEROSUM* L.) PËR PARAMETRA FIZIOLOGJIK”

(Punim Masteri – MSc)

Mentor:
Prof. Dr.sci. SaliAliu

Kandidate:
Bsc. Floranda Zymberi

Prishtinë, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

Fakulteti I Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Lavërtari-Perimtari



**“ANALIZA E DISA POPULACIONEVE TË PATATES (*SOLANUM TUBEROSUM* L.)
PËR PARAMETRA FIZIOLOGJIK”**

(Punim Masteri – MSc)

**“ANALYSIS OF SOME POTATO (*Solanum tuberosum* L.) POPULATIONS FOR
PHYSIOLOGICAL PARAMETERS”**

(Master Thesis - MSc)

Mentor:
Prof. Dr. SaliAliu

Kandidate:
Bsc.Floranda Zymberi

Prishtinë, 2023

PERMBLEDHJE

Nga sipërfaqja e përgjithshme punuese në Kosovë (577.000 ha), vetëm 7000 ha janë të mbjella me patate ose shprehur në vlerë relative është 1.21%. Në strukturën e mbjelljes së kulturave bujqësore në Kosovë, patatja radhitet pas grurit dhe misrit. Rendimentet mesatare, që realizohen në shkallë vendi për njësi të sipërfaqes janë 13.4 t/ha, krahasuar me vendet tjera, mesatarja e rendimentit ende është e ulët. Ruajtja e diversitetit të gjermplasmës dhe shfrytëzimi i tyre në programe të përmirësimit gjenetik për shkak të zvogëlimit dhe humbjes së këtij materiali nga shumë faktorë përfshirë ata ekonomikë, si dhe ndryshimeve të përgjithshme klimatike në të ardhmen duket të jetë në rrezik. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte karakterizimi dhe evoluimi fenotipor për parametra fiziologjik të disa populacione lokale të patates (*Solanum tuberosum* L) të kultivuara nga fermerët tanë në kushtet agroekologjike të Kosovës. Si material i punës kanë shërbyer akcesionet e grumbulluara dhe të ruajtura në bankën e resurseve gjenetike bimore (BRGJB) pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë. Metoda e veprimit për këtë natyrë të punës ishte e bazuar sipas asaj standarde. Mbjellja është realizuar në laborator, matjet biometrike dhe përcjellja e parametrevë bimorë është realizuar deri në përfundim, kurse më pas janë kryer analizat. Dizajni ishte eksperimentale laboratorike (EL) ishte sipas bllokut të randomizuar (RCBD) me tri përsëritje. Hulumtimet tona me akcesione të patates për kushtet agroekologjike të Prishtinës tregojnë se akcesionet edhe pse ishin të analizuara në kushte të njëjta laboratorike u karakterizuan me variabilitet gjenetik për parametra fiziologjik, sepse ishin me origjinë të ndryshme. Dallimet e analizuara në mënyrë statistikore, ishin lartë sinjifikante për të dy nivelet $DMV_{p=0.05}$ dhe $DMV_{p=0.01}$

ABSTRACT

From the total working area in Kosovo (577,000 ha), only 7000 ha are planted with potatoes or expressed in relative value is 1.21%. In the planting structure of agricultural crops in Kosovo, the potato ranks after wheat and corn. The average yields, which are realized on a national scale per unit of area, are 13.4 t/ha, compared to other countries, the average yield is still low. The preservation of germplasm diversity and their use in genetic improvement programs due to the reduction and loss of this material by many factors, including economic ones, as well as general climate changes in the future seems to be at risk. The main purpose of this research was the characterization and phenotypic evolution for physiological parameters of some local populations of potato (*Solanum tuberosum* L) cultivated by our farmers in the agroecological conditions of Kosovo. Accessions collected and stored in the bank of plant genetic resources (BRGJB) at the Faculty of Agriculture and Veterinary Medicine in Prishtina served as working material. The method of operation for this nature of work was based on that standard. The planting was carried out in the laboratory, the biometric measurements and monitoring of the plant parameters were carried out until completion, and then the analyzes were carried out. The design was experimental laboratory (EL) according to the randomized block (RCBD) with three replications. Our research with potato accessions for the agroecological conditions of Pristina shows that the accessions, although they were analyzed under the same laboratory conditions, were characterized by genetic variability for physiological parameters, because they were of different origin. Statistically analyzed differences were highly significant for both levels $LSD_p=0.05$ and $LSD_p=0.01$